

Pse Albanon?

Të dashur lexues,

Botimi i revistës kulturore “Albanon”, nismë e një grupi dashamirësish të traditës kulturore, të historisë e vlerave qytetare të përvijuara tashmë në trevën e Elbasanit e më gjerë, bën hapin e parë, si angazhim drejt pasqyritimit të këtyre vlerave.

Nismat e kësaj natyre lindin të nxitura nga një realitet që ofron me bujari histori, por që parashtron me po aq ngulm edhe nevojën e angazhimeve intelektuale që ndihmojnë për të përcaktuar kahjet e lëvizjes drejt së ardhmes.

Të njohësh të shkuarën, do të thotë të jetosh më intensivisht të tashmen, sepse i shmangesh krizës së modelit, ndihmohesh ta tejkalosh atë, sepse je më i orientuar në hapat që hedh; do të thotë, gjithashtu, ta synosh më i sigurt të ardhmen, sepse e shkuara dhe e tashmja veçse të nxisin për t’u bërë *aktor* i situatave që vijnë, kudo, duke filluar nga familja, nga rrethi shoqëror i ngushtë e më gjerë.

“Albanon” do të mirëpresë në vijimësi angazhimet intelektuale për të ndihmuar lëvizjen në këto kahje. Dhe kjo lëvizje është rezultante e përpjekjeve të një komuniteti të tërë, zërin e të cilit duhet të dimë ta dëgjojmë e amplifikojmë.

Edhe pse, në pamje të parë, botimi i revistës që nismë për të nxjerrë në pah kontributet kryesisht lokale, vetvetishëm në kohën tonë kufij të ngushtë lokalë janë nën tryshninë e prirjes për zgjerim hapësire, sepse vlerat përftohen në një bashkëmarrëdhënie shumë më të gjerë entitetesh, hapësire dhe kohe. Pikërisht kjo tryshni motivoi edhe emërtimin e revistës me emrin “Albanon”, që bart edhe simbolikë etno-historike, edhe prirjen për hapësirë njëherazi të lokalizuar në një trevë, por edhe kufij në zgjerim e në lëvizje, duke bartur bashkë me historinë edhe një sërë enigmash, të thënash e të pathënash ende, që mbajnë gjithnjë të ndezur kërkshërinë.

Për të nxitur e plotësuar këtë kërkshëri të lexuesit, “Albanon” do të sjellë informacione dhe trajtesa të ndryshme përmes rubrikave të pranishme në të, që parakuptojnë të dhëna dhe interpretime për historinë, etnografinë, arkeologjinë, arsimin, doket, zakonet; për personalitetet që ndihmuan në

këtë histori e bënë histori, por edhe për çështje të ndryshme të aktualitetit e nevojës për zhvillim të vlerave të përfutuara tashmë.

Priremi t'i shtojmë dhe t'i thellojmë këto tematika, sepse priremi të përgatitemi dhe aftësohemi më tej për t'i dhënë mjedisit ku jetojmë e punojmë vlerën e një komuniteti të denjë edhe për të sotmen. Ndaj hapësira botuese e "Albanon" do të jetë një ftesë e përhershme për studiuesit e intelektualët elbasanas, dashamirët e të pasionuarit pas vlerave të përfutuara tashmë dhe ftesë për të gjithë ata që mëtojnë çdo ditë t'i përsosin këto vlera. "Albanon" do të synojë që të nxisë atë çka shpirti i këtij komuniteti kultivoi, barti, trashëgoi, për të qenë më të aftë që të dimë se ç'duhet të kultivojmë më tej, ç'duhet të mënjanojmë e ç'duhet të nxisim.

Le të shpresojmë që rrugëtimi i revistës do të jetë i suksesshëm dhe mëtimet e saj, edhe pse modeste, do të jenë të dobishme.